



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 05.02.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme.
2. Seancë dëgjimore për plotësimin e vendit vakant, për kryetar të Bordit të AMF-së, me kandidatët: Pajtim Melani, Bilal Kola, Ardit Çollaku, Olsi Çoku.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Vullnet Sinaj, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Edmond Haxhinasto, Fatbardha Kadiu, Ismet Beqiraj, Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Agron Shehaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Nadire Meçorapaj, Përparim Spahiu

Të ftuar:

Pajtim Melani, Bilal Kola, Ardit Çollaku, Olsi Çoku

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Sot kemi dy pika në rendin e ditës: miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme; seancë dëgjimore për plotësimin e vendit vakant, për kryetarin e Bordit të AMF-së me kandidatët: Pajtim Melani, Bilal Kola, Ardit Çollaku, Olsi Çoku.

Besoj se procesverbalet u kanë shkuar anëtarëve të komisionit. Ka ndonjë koment për procesverbalin, para se ta kalojmë për miratim? Nuk ka. Atëherë, e quajmë të miratuar procesverbalin të mbledhjes së mëparshme.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, ku kemi parashikuar zhvillimin e seancës dëgjimore me kandidatët për plotësimin e vendit vakant, për kryetar të Bordit të AMF-së, pas përfundimit të mandatit të zotit Pajtim Melani.

Bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për AMF-në”, i ndryshuar”, kryetari i AMF-së emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit parlamentar për Ekonominë dhe Financat, pas një procedure përzgjedhëse.

Kuvendi, në përputhje me afatet ligjore ka shpallur vakancën për këtë pozicion. Më 21 janar 2019 ka përfunduar afati i propozimit të kandidaturave për kryetar të Bordit të AMF-së. Ky vend do të rezultojë vakant pas datës 12.3.2019.

Nga informacioni i marrë nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Kuvendit, rezulton se janë paraqitur 4 kandidatura, konkretisht: Pajtim Melani, Bilal Kola, Ardit Çollaku dhe Olsi Çoku. Përzgjedhja e kandidaturave, që kanë aplikuar bëhet duke u bazuar në procedurat dhe në afatet e përcaktuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton:

“Kandidaturat për në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me përjashtim të rasteve, kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, duhet të paraqiten me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë dhe të përmbajnë një *Curriculum vitae* të kandidatit dhe pëlqimin e tij për kandidimin.

Kandidaturat duhet të propozohen 45 deri në 30 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit dhe jo më vonë se 10 ditë pas shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues apo të krijuar me ligj.

Me paraqitjen e kandidaturave, Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisionit përkatës, i cili vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kushtet ligjore brenda tri javëve nga marrja e kërkesës.

Kuvendi kryen votimin për kandidatët jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i mandatit ose nga data e shkarkimit.

Në rastet kur zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj bëhet nga Kuvendi, me propozim të institucioneve të tjera, procedohet sipas pikës 3 të këtij neni. Kuvendi shqyrton kërkesën në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.

Në të gjitha rastet, komisioni përkatës, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, shqyrton përmbushjen e kriterëve kushtetuese e ligjore dhe meritën e çdo kandidature. Komisioni organizon seanca dëgjimore publike me secilin kandidat. Në rastin kur ka mangësi në dokumentacion për kandidaturën, komisioni i kërkon Kryetarit të Kuvendit të njoftojë institucionin propozues për plotësimin e tyre.

Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve, kur është parashikuar ndryshe.”

Përpara fillimit të seancës dëgjimore me kandidatët, po evidentoj edhe kërkesat për t’u emëruar anëtar i Bordit të AMF-së, të parashikuara nga neni 5 i ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për AMF-në”, i ndryshuar””.

“1. Duhet të jenë shtetas shqiptarë.

2. Të kenë përfunduar ciklin e plotë të studimeve universitare në një nga këto fusha: ekonomi, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve

3. Me përvojë profesionale të paktën 7- vjeçare, nga e cila, të paktën, 5 vjet në njërën nga këto fusha ose në disa prej tyre të marra së bashku:

a) financë-kontabilitet;

b) administrim i shoqërive tregtare;

c) këshillim ligjor i shoqërive tregtare;

ç) hartim legjislacioni;

d) shkencë e aktuarëve;

dh) sigurime shoqërore dhe pensione.

4. Me integritet moral dhe profesional.

5. Të paangazhuar në funksione drejtuese partiake.

6. Të pashpallur si të dënuar penalisht, me vendim gjykate të formës së prerë.

7. Në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave.

Nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Autoritetit personat, të cilët:

a) në 3 vjetët e fundit kanë qenë ortakë, aksionarë, apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura;

b) kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi;

c) në 3 vjetët e fundit kanë qenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura.

Kryetari dhe dy anëtarët e tjerë të Bordit mund të jenë të punësuar me kohë të plotë në detyra të tjera, por nuk lejohen të jenë anëtarë të më shumë se 1 bordi apo organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.

Çdo anëtar i Bordit ka detyrimin të deklarojë përpara Kryetarit të Kuvendit, në lidhje me rrethanat e parashikuara në këtë nen.”

Atëherë, fillojmë seancën dëgjimore me kandidatët.

Urdhëroni!

Jorida Tabaku – Kandidatura e kryetarit do t’i përcillet Kuvendit me firmat e deputetëve, apo do të ketë vetëm sugjerimin e Komisionit të Ekonomisë?

Arben Ahmetaj – Kjo është pa firma, do të shkojë vetëm nga Komisioni i Ekonomisë. Është një rast tjetër ai me 28 firma të deputetëve. Unë numërova të gjithë procedurën, por jo domosdoshmërisht se cila bie në...

Jorida Tabaku - Kryetar,

Unë dua të ngre edhe një herë shqetësimin, që ngrita dje. Të paktën PD-ja dhe LSI-ja, që është prezente këtu, nuk janë përfshirë në asnjë proces të propozimit të kandidaturave dhe nuk jemi informuar për procesin në fjalë. Ju thoni se është bërë njoftimi nga Kryetari i Kuvendit. Normalisht, ky njoftim nuk u është përcjellë grupeve tona parlamentare. Të paktën të kishim dijeni dhe të sugjerim edhe ne kandidaturat për të marrë pjesë në këtë proces. I njëjti diskutim është me shqetësimin që unë ngrita dje për procesin që u ndoq në BSH, i cili ishte një proces i njëanshëm, pa përfshirë opozitën në asnjë procedurë në mënyrë të paprecedente në propozimet që vijnë nga deputetët e opozitës.

E njëjta procedurë ka ndodhur edhe me institucionet e tjera. Nuk i referohem vetëm Komisionit të Ekonomisë, por po flas në përgjithësi. Është një shqetësim se opozita nuk ka asnjë hapësirë përfaqësimi në këto organe, të cilat janë të gjitha organe të pavarura. Normalisht, në traditën parlamentare, por njëkohësisht edhe në përfaqësimin e ndryshëm që përpara vitit 2013 e që në fillimet, kur këto institucione janë krijuar, ka pasur një raport dhe një balancë të forcave

politike për propozimet, që vinin me firmat e grupeve të ndryshme të deputetëve. Kjo nuk ka ndodhur në këto 5 vjet, përveç një rasti në Autoritetin e Konkurrencës.

E ngre edhe një herë këtë shqetësim. Uzurpimi i Bordit të BSH-së dhe i bordeve të të gjitha institucioneve të pavarura, pa pjesëmarrjen e opozitës dhe proceset e kryera në mënyrë të njëanshme, pa pritur propozimet e opozitës, në pjesën më të madhe të këtyre institucioneve, ka bërë që të gjitha këto institucione të jenë të kapura nga qeveria dhe të mos kenë asnjë balancë dhe të mos kryejnë as funksionin e tyre kushtetues, që është mbikëqyrja si funksion bazë, sepse të gjitha janë autoritete apo agjenci mbikëqyrëse.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Tabaku!

Besoj se edhe ju jeni në dijeni të plotë të procedurës se si veprohet në rastin konkret. Besoj se ligji është i drejtpërdrejtë dhe nuk ka asnjë klauzolë ligjore që t'i referohet pozitës ose opozitës. Përkundrazi, procedura është e shkruar qartë që është një procedurë e hapur me aplikim. Në dijeninë time zyrtare, është bërë një proces i hapur dhe besoj se nëpërmjet kësaj procedure edhe ju e kishit mundësinë për të mbështetur kandidatura, të cilat mund të kenë natyrshëm, një afilim të djathtë.

Megjithatë, nga çfarë po shoh, për kandidaturat besoj se edhe opozita mund të thotë se nuk ka asnjë të asociuar, sepse të katërta kandidaturat, në dijeninë time, janë profesionistë

Megjithatë, ju falënderoj për vërejtjen dhe për opinionin. Sigurisht, që do t'ia transmetojmë edhe Kryetarit të Kuvendit këtë që thatë ju.

Atëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

Edmond Spaho – Zoti kryetar,

Është e vërtetë që ligji nuk parasheh kuota, apo referime pozitë-opozitë, por ka një praktikë të ndjekur prej shumë e shumë vitesh, pavarësisht se kush ka drejtuar (e majta apo e djathta), që në institucionet e rëndësishme të sigurohet përfaqësimi i të gjithë krahëve. Sigurisht, profesionizmi nuk ka nevojë që të ketë krahë, por dihet se sa e politizuar është jeta në Shqipëri. Gjithmonë ka qenë e nevojshme që të gjithë krahët të mund të përfaqësohen në këto institucione, në mënyrë që të reflektohen në politikëbërje opsionet më të mira të mundshme, si dhe të garantohet kontrolli dhe mosabuzimi me pushtetin. Kemi shumë raste, ku institucionet e ngritura në mënyrë të njëanshme veprojnë me dy standarde. Po ju sjell rastin e fundit, ku prokurorja e Krimeve të Rënda e kapërcen vetingun, në një kohë, kur për të njëjtat shkelje,

kolegët e saj janë rrëzuar. Këtu defekti qëndron në mënyrën se si është krijuar komisioni. Trupa gjyquese ka 3 përfaqësues të maxhorancës, madje 2 prej tyre (nuk po them 3 të maxhorancës), që të mos t'i biem në qafë kryetarit, por 2 prej tyre kanë punuar në Kryeministri, kanë qenë ndihmës të Kryeministrit. Për rrjedhojë, rezultati është ky që patëm sot. Dua të them se është e domosdoshme të kemi përfaqësim nga të gjitha krahët për të evituar situata të tilla, ku politikat dhe vendimet merren në interes të një force politike dhe jo në interes të vendit.

Arben Ahmetaj – Më fal!

Besoj se nuk jeni duke paragjykuar reformën në drejtësi në Komisionin e Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë s'ju ndërpreva.

Edmond Spaho – Unë nuk paragjykoj reformën në drejtësi, por po i referohem një fakti konkret.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo për të cilën prokurorët e tjerë janë rrëzuar, nuk e kanë kaluar vetingun për evazion fiskal, Donika Prea e kaloi për shkak të...

Arben Ahmetaj – Më falni!

Këtu kemi vendosur një procedurë, që të mos ta ndërpresim njëri-tjetrin. Në qoftë se ju do të më ndërprisni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, kemi një procedurë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Secili nga ne do të shprehë mendimin e tij. Pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Secili ka opinionin e vet. Zoti Spaho vjen në Komisionin e Ekonomisë dhe gjatë procedurës së seancës dëgjimore, flet për reformën në drejtësi, në të kundërtën e asaj që është logjika e Kuvendit.

Të paktën, ta dëgjojmë njëri-tjetrin zoti Spaho, sepse në qoftë se bëjmë kakofoni, as ju, në eksperiencën tuaj, as mua nuk na shkon të flasim në të njëjtën kohë. Të paktën, jo unë dhe ti.

Fol sa të duash, edhe një orë po deshe! Je në të drejtën tënde. Unë do të të dëgjoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa herë të duash.

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Sot jemi këtu për të zhvilluar një seancë dëgjimore për plotësimin e vendit vakant, për kryetar të Bordit të AMF-së. Le të fokusohemi këtu!

Nëse doni të bëjmë një seancë dëgjimore, apo debat për reformën në drejtësi, për vetëingun, apo se si ka funksionuar, jam gati ta bëjmë me kënaqësi, por sot le të fokusohemi te rendi i ditës.

Faleminderit!

Urdhëro, Ervin!

Ervin Bushati – Për procedurë.

Më vjen keq, që opozita është në një situatë jo vetëm absurde, por edhe pa kuptim. Ndërkohë, që bojkoton parlamentin, institucionin kryesor, tani thotë që nuk ka pasur kohë të propozojë kandidatët e vet, ndërkohë që gara ka kohë që është shpallur. Kjo nuk ka kuptim.

Nga njëra anë, nuk e njihnit këtë qeverisje (deri para një jave), ndërsa tani thoni se e njihni, por thoni se ju është hequr mundësia të paraqisni kandidatët tuaj, ndërkohë që nuk keni marrë pjesë në punimet e institucionit kryesor, në parlament. Prandaj, këto zgjatje janë të kota. Jeni të mirëpritur në të gjitha garat e tjera. Ju kemi ftuar edhe te Bordi i BSH-së, edhe te të gjitha bordet. Ju nuk keni marrë pjesë në punimet e parlamentit. Përderisa nuk keni marrë pjesë në parlament, si prisni të merrni pjesë këtu?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Fjalën e ka zoti Spaho!

Edmond Spaho – Nuk është fjala për të njohur qeverisjen, se ne nuk e njohim qeverisjen, por po flasim për institucionet e pavarura. Po flasim për ngritjen dhe për funksionimin e institucioneve të pavarura do t'i ngremë kështu si ju po operoni këto vitet e fundit, ku shkelni traditën që kemi pasur si Kuvend, ku të gjitha palët përfaqësoheshin në to, do të arrijmë të kemi institucione si ky që iu referova, ku për të njëjtat shkelje shumica rrëzohet dhe vetëm Prokuroria e Krimeve të Rënda e kalon lumin.

Arben Ahmetaj - Çfarë lidhje ka kjo?

Edmond Spaho - Ka lidhje, sepse duke u ngritur institucionet në këtë mënyrë do të merren vendime, të cilat nuk janë në interes të qytetarëve, por janë në interes të maxhorancës, sepse janë të gjitha të maxhorancës, sikurse ndodhi te komisioni i vetëingut, ku dy punonjës të Kryeministrit ngritën dorën për dakord dhe e kaluan. Unë shqetësohem edhe në rastin kur plotësoni institucione të tjera si Autoriteti i Konkurrencës, Banka e Shqipërisë, qoftë edhe

institucione, si: Autoriteti Rrugor, ku ligji mund t'ju japë të drejtën për t'i emëruar ju punonjësit, por ju emëroni punonjës të tillë që e nxjerrin koston e 1 kilometri 20 milionë euro, marrin dokumente të falsifikuara dhe i quajnë të rregullta. Kjo është e keqja që kur vepron kështu...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo nuk është politikë. Nëse është politikë, unë tërhiqem, por është fakt dhe e keni pranuar dhe ata janë në ndjekje penale tani.

Nëse ti e quan politikë, vaj hallit për ty!

Arben Ahmetaj - Zoti Spaho, më falni një sekondë.

Nëse doni të bëjmë një debat politik, jeni të ftuar ta bëjmë, por këtu nuk jemi duke folur për institucionet e drejtësisë dhe për vetingun. Besoj se ju keni mundësi ta monitoroni, por atë e monitorojnë institucionet edhe përtej Republikës së Shqipërisë, si: SHBA-të dhe Komisioni European. Praktikisht vetingu po ecën ashtu siç ishte parashikuar, ndoshta ne duam të ecim më shpejt, që të kemi institucionet, por shumë shpejt, në qershor, do të jenë ngritur SPAK-u edhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Të gjitha komentet këtu le t'ua lemë institucioneve të pavarura dhe drejtësisë dhe të mos komentojmë këtu jo 20 milionë euro, jo Rrugën e Kombit ka bërë 12 milionë euro, jo kjo tjetra, që bën 9 milionë euro, jo ajo që bën 20 milionë euro, sepse për inxhinierët, për ambientalistët, për financierët, për ekonomistët, për minatorët, për të gjithë diskutojmë këtu ne dhe nuk i lemë, pikërisht, institucionet e drejtësisë që të bëjnë punën e tyre nëse është në ndjekje penale, apo nuk është në ndjekje penale.

Unë këtu do t'ju lutesha për dy gjëra: nëse duam të bëjmë debat politik, hajdeni ta quajmë një seancë debati politik, dhe të bëjmë sa të doni. Këtu jemi për një pikë shumë të rëndësishme dhe mos harroni që është nga institucionet më të rëndësishme të administrimit të sistemit të institucioneve financiare jobankare. Pra, jemi duke folur për një institucion, i cili është shtyllë e sistemit financiar në Shqipëri, ndërkohë ju bëni debat jo politika andej, jo politika këndeje. Unë do t'ju lutesha që të jemi në linjë me njëri-tjetrin, të mbarojmë, të dëgjojmë kandidatët, sepse jemi duke folur për një nga pozicionet më të rëndësishme në sistem, atë të kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ndaj duhet t'i japim rëndësinë e duhur.

Edmond Spaho - Zoti Ahmetaj, kam edhe diçka dhe mbaroj.

Ju keni shumë të drejtë, sepse ne duhet t'u referohemi institucioneve të pavarura, për shembull, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili e ngriti këtë çështje, që unë po e referoj si një shembull negativ për mënyrën se si ju ngrini institucionet, dhe kërkoi që kjo zonja, që përmendet, të mos e kalojë vetingun. Madje, ky operacion ishte turpëruar kur kishte parë praktikatat se si kishte vepruar ajo në lidhje me pasurinë që kishte krijuar.

Arben Ahmetaj - Po, zoti

Edmond Haxhinasto - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se debati këtu nuk është politik, aq sa është institucional dhe ligjor. Mendoj se të gjithë rreth kësaj tryeze janë të interesuar që, pavarësisht se në çfarë pozicioni ndodhen, në maxhorancë apo në opozitë, përzgjedhja e institucioneve, të cilat janë garantuese të sistemit, rregullojnë sistemin, krijojnë *check end balance*, pra kontrollin dhe balancimin e pushteteve, që shkon shumë përtej këtij institucioni. Pra, ekzistenca e këtij sistemi kontrollues dhe balancues është edhe në interesin tuaj. Ju sigurisht i keni ngritur këto gjëra kur keni qenë në opozitë, por është e natyrshme që harrohen kur jeni në maxhorancë, sepse gjithkujt që është në maxhorancë i pëlqen që të administrojë procesin e emërimeve, caktimeve apo të zgjedhjes së drejtuesit të institucioneve. Mendoj se dy janë elementet: ose e parashikon ligji mënyrën se si zgjidhen, në kuptimin se çfarë përkatësie kanë, ose është tradita. Tani, tradita kërkon që ta bëjmë konsensus, por dihet se konsensusi në këtë vend ka vdekur me kohë. Kështu, ndoshta do të ishte me vend, por edhe në interesin tuaj në një të ardhme, ndoshta kur të vijë momenti i një rotacioni politik, të bëhet një vlerësim i tillë: sa institucione të vendit, sa institucione të pavarura, sa institucione garantojnë normalitetin e sistemit financiar, por edhe të sistemeve të tjera, mund të emërohen nga një maxhorancë me 71 vota? A e keni bërë këtë vlerësim? Nuk e keni bërë dhe të jeni të bindur që kjo përqindje mund të jetë shumë më e lartë. Unë nuk e kam analizuar, por ndoshta është për t'u analizuar, sepse ndoshta 90% e institucioneve mund të zgjidhen nga një maxhorancë dhe ky është një problem i madh për sistemin, nuk është problemi për këtë anë apo për atë anën tjetër të tryezës. Ndaj, të mos kalojmë në retorika, sepse kjo është çështje e sistemit. Unë ndoshta do t'ju kërkoja që të bëhet një vlerësim: sa institucione të pavarura mund të zgjidhen drejtpërdrejt nga një maxhorancë e thjeshtë? Ky është një problem për mendimin tim, sepse do të jetë problem edhe nesër kur të jetë një maxhorancë tjetër.

Patjetër që kandidaturat, të paktën zoti Melani, të cilin e njoh prej vitesh, ia vjen përkatësia e tij, angazhimi i tij, qoftë profesional, që është i ditur tashmë, që është i pacenueshëm dhe i padiskutueshëm. Këtë duhet ta kemi parasysh kur bëjmë përzgjedhje.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Më falni, përtej asaj që thatë, le t'i referohemi ligjit, sepse ligji specifik e ka shumë të qartë procedurën dhe nuk flet fare për përkatësitë partiake. Ligji është bërë në vitin 2006 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Haxhinasto, unë nuk ju ndërpreva asnjëherë.

Ligji e ka shumë të qartë dhe nëse flisni për përkatësi partiake, hajdeni ta bëjmë atë analizë dhe të kuptoni që KLSH-ja në të gjithë historinë e institucionit ka qenë e drejtuar nga Partia Demokratike. Bëni një kërkesë dhe hajdeni ta bëjmë së bashku atë analizë, t'ia paraqesim edhe Kuvendit, por rasti konkret është e zeza në të bardhë. Procedura se si përzgjidhet kryetari i bordit është shumë e qartë: me shpallje publike, me aplikim publik, me dëgjese publike, me propozim të Komisionit të Ekonomisë, që i shkon seancës. Ne jemi duke folur për një nga institucionet më të rëndësishme të monitorimit të sistemit financiar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Unë dua t'ju kujtoj një moment, zoti Spaho, zoti Haxhinasto, por edhe zonja Tabaku, vitin 2012, kur ishim në opozitë dhe dhamë konsensusin e menjëhershëm për ligjin e Bankës së Shqipërisë, qoftë për Brige Bank, qoftë për elementet e tjerë. Pse? Sepse për institucionet financiare nuk diskutohet me frymë politike, sepse nuk ka balancë politike në një maxhoracë me 71 vota me një maxhorancë me 84 vota. Prandaj, do t'ju lutesha të mos e hapim këtë debat politik këtu, aq më tepër që i kemi të katër kandidatët prezentë, ndaj të fillojmë me dëgjesën.

Zoti Melani, ju lutem.

Pajtim Melani - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju falënderoj për mundësinë që më dhatë për t'u dëgjuar në këtë seancë të rikandidimit tim!

Sipas njoftimit të Kuvendit të datës 11 janar, kam aplikuar për të drejtuar në mënyrë joekzekutive, duhet theksuar kjo, sepse kryetari i bordit është joekzekutiv në drejtimin e bordit të AMF-së. Mendoj se i kam të qarta sfidat e zhvillimit të ri financiar, instrumentet ligjore dhe rregullatore, sepse tashmë kemi një strategji zhvillimi dhe një plan veprimesh afatmesme, kemi eksperiencën dhe vizionin për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve, aktivitetin, zhvillimin dhe stabilitetin e tregjeve.

Gjatë katër vjetëve të drejtimit të bordit në mënyrë periodike ne kemi raportuar në Komisionin e Ekonomisë, sigurisht më shumë sesa një herë në vit. Për shkak të specifikave apo çështjeve të veçanta, ne kemi detyrimin të raportojmë në mënyrë vjetore, po ashtu edhe për çështje të veçanta të komisionit. Kështu, personalisht mendoj se kam qenë dhe do të vazhdoj të mbetem i hapur për të dëgjuar të gjitha pyetjet dhe shqetësimet e deputetëve për çdo çështje.

Eksperienca e fituar në këto vite të ndërtimit të bordit lidhet me zhvillimin dhe rregullimin e tregjeve financiare. Diskutimet dhe pjesëmarrjet e mia aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht ato pranë institucioneve europiane të tregjeve

financiare, Komisionit për Bursën dhe Letrat me Vlerë në SHBA, Bankës Botërore e kështu me radhë. Në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore kam ndjekur hap pas hapi zbatimin e projektit për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së. Ky është një projekt, i cili është mundësuar nga qeveria zvicerane dhe është zbatuar nga Banka Botërore. Gjithashtu, FMN-ja dhe Banka Botërore kanë vlerësuar progresin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare lidhur me përmirësimin, si dhe adoptimin e një kuadri të ri rregullativ, në lidhje me mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve dhe të fondeve të investimit, duke përmendur: hartimin e rregulloreve për administrimin e likuiditetit dhe fondeve të investimit, transaksioneve me palët e lidhura e kështu me radhë.

Mendoj se kemi pasur si prioritet maksimal zbatimin me përpikmëri të rekomandimeve të Kuvendit në të gjitha vitet që unë kam qenë në këtë pozicion. Komisioni European në progresraportin e fundit ka vlerësuar AMF-në në drejtim të funksionimit të plotë dhe eficient të bordit, duke theksuar se legjislacioni sekondar i miratuar nga AMF-ja është në përputhje me direktivat Solvency I dhe II, ka progres në licencimin e bursës së parë private, e cila u bë efektive në shkurt të vitit 2018, si dhe ka filluar zbatimin e strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorëve dhe investitorëve në tregjet e mbikëqyrura.

Unë, duke përfaqësuar AMF-në në grupin zhvillimor të stabilitetit financiar, i cili drejtohet nga ministri i Financave, ku marrin pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, mendoj se kam dhënë një kontribut modest në zhvillimin dhe stabilitetin financiar të Shqipërisë.

Tregjet financiare, nën mbikëqyrjen e AMF-së, kanë shënuar zhvillime pozitive gjatë kësaj periudhe dhe këtu po përmend: licencimin e Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE, e cila për momentin ka në objektin e saj vetëm titujt e qeverisë, bonot dhe obligacionet e thesarit në tregun sekondar.

Dua të theksoj se nga shkurti i vitit të kaluar janë tregtuar mbi 21 milionë euro në tregjet sekondare të letrave me vlerë. Zhvillimi i tregut sekondar i letrave me vlerë ka qenë një rekomandim i vazhdueshëm i Bankës Botërore dhe FMN-së. AMF-ja po ecën në drejtim të licencimit të regjistrit të titujve dhe mendoj se në vjeshtën e këtij viti do të fillojë edhe tregtimi i obligacioneve tregtare dhe i shoqërive tregtare. Më pas, në vitin 2020, siç kemi bërë gjatë gjithë kësaj periudhe, do të fillojë edhe listimi i aksioneve për shitblerjen në bursën shqiptare.

AMF-ja ka ndjekur një politikë të kujdesshme të mbikëqyrjes dhe rregullimit të fondeve të investimeve, duke miratuar rregullore të përafruara me legjislacionin european, kryesisht në drejtim të transparencës dhe menaxhimit të likuiditetit. Sigurisht, rritja në vitet e para shtroi para AMF-së detyrimin për të pasur një bazë rregullative të qartë për sa i përket transparencës për

investitorin, i cili duhet të jetë i qartë për investimin në fondin e investimeve. Fondet aktualisht kanë një vlerë asetesh rreth 65 miliardë lekë ose rreth 520 milionë euro dhe ky treg, duhet theksuar, dominohet kryesisht nga investimet në obligacionet qeveritare.

Tregu i pensioneve private, megjithëse ka pasur një bazë të ulët, ka pasur rritjen më të fortë vit pas viti, një rritje dyshifrore, pra, disa herë më shumë se rritja ekonomike e vendit dhe aktualisht ka një total asetesh prej 2 miliardë e 177 milionë lekësh. Rritja vjetore për këtë vit është 26%.

AMF-ja është fokusuar në rritjen e besimit të konsumatorët dhe investorët, duke miratuar një strategji të posaçme.

Sipas parashikimeve të nenit 15, pika 3, të ligjit “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” në dy raste kam urdhëruar ngritjen e komiteteve të kontrollit për ekzekutivin e AMF-së për të ndjekur parimin e *check end balance*, sepse, siç e thashë, drejtori dhe nëndrejtori i Përgjithshëm kanë funksionet ekzekutive të bordit, ndërsa tre anëtarët e tjerë joekzekutivë krijojnë automatikisht Komitetin e Kontrollit të Ekzekutivit dhe paraqesin raporte auditimi, të cilat më pas ia paraqesin Kuvendit, posaçërisht Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Gjithashtu, sipas parashikimeve të nenit 15, pika 45, në cilësinë e kryetarit të bordit, kam propozuar në dy raste ngritjen e Komitetit Këshillimor të Bordit të AMF-së, i cili ka propozuar dokumentin e zhvillimit strategjik. Ne tashmë, me vendimin e bordit nr.78, datë 28.04.2018, kemi një plan për zhvillimin e AMF-së dhe të tregjeve në mbikëqyrje për periudhën 2018-2020, i diskutuar gjerësisht me Bankën Botërore, FMN-në, Ministrinë e Financave, operatorët e tregjeve, konsumatorët dhe të gjitha palët e tjera të interesuara. Për këtë kemi bërë edhe disa prezantime, ku të pranishëm kanë qenë edhe anëtarët e nderuar të këtij komisioni.

Mendoj se ky dokument strategjik, i ndërthurur me rishikim e kuadrit ligjor dhe rregullator, duhet të përbëjë prioritet për zhvillimin e AMF-së në vitet e ardhshme për ta kthyer atë në një institucion më inovativ, më prokonsumator, më të besueshëm, më transparent dhe më llogaridhënës para Kuvendit.

Objektivat kryesorë, nëse unë do të jem në këtë pozicion, do të lidhen me:

1. Zhvillimin e produkteve ekzistuese dhe të reja në tregun e sigurimeve (këtu kam parasysh projektligjin “Për sigurimin nga katastrofat”, projektligjin “Për sigurimin nga palët e treta”, “Për profesionet e lira” e kështu me radhë), dhe miratimin e kuadrit rregullator, pas ndryshimeve në ligjin “Për sigurimet e detyrueshme”, kryesisht për zbatimin e sistemit bonus-malus.

2. Zhvillimin e tregut të kapitaleve, nëpërmjet procesit të diskutimit të hapur me Komisionin e Ekonomisë, Bankën Botërore dhe FMN-në, duke dëgjuar të gjitha shqetësimet me palët e interesit për ta bërë procesin sa më transparent. Unë mendoj se do të jetë shumë në avancë për Komisionin e Ekonomisë versioni i të dyja projektligjeve: “Për titujt ekzekutivë” dhe “Për fondet e investimeve”, të draftuara nga ekspertët e projektit të Bankës Botërore në përputhje me direktivat e BE-së, të cilat meritojnë një konsultim të gjerë para miratimit.

3. Licencimin e Regjistri Shqiptar të Titujve, ALREG, dhe plotësimin e kuadrit rregullator, që, siç e thashë, pritshmëritë janë që të kemi një zhvillim të tregut të kapitaleve dhe fondit të investimit, ndryshe nga ç’ka ndodhur më parë. Ne kemi pasur një periudhë kur këto nuk ekzistonin, por kur u bënë të prekshme, siç e përmenda, në tregun sekondar filluan të tregtohen 21 milionë euro. Unë mendoj se në vjeshtën e këtij viti do të kemi obligacione tregtare të listuara, më pas aksione dhe pse jo edhe obligacione bashkiake, si instrumente të rëndësishme në zhvillimin e projekteve, që janë vizibël. Gjithmonë do të jemi në bashkëpunim me Ministrinë e Financave për të respektuar edhe kufijtë e borxhit.

4. Zhvillimin e kolonës II të pensioneve, sipas praktikave më të mira dhe rekomandimeve të Bankës Botërore, së fundi, edhe të misionit të FMN-së, i cili thekson se kjo do të forconte sigurinë sociale, do të rriste kohezionin social dhe do të thellonte zhvillimin e tregut të kapitalit nëpërmjet instrumenteve financiare.

Unë mendoj se gjatë këtij viti ne jemi në procesin e ndryshimeve ligjore dhe rregullative. Shqipëria është përzgjedhur si vendi organizator i takimit vjetor të Organizatës Ndërkombëtare të Pensioneve, IOPS, që mbahet në vjeshtën e këtij viti, e cila do të jetë një mundësi shumë e mirë për të marrë eksperiencat më të mira për zhvillimin e pensioneve private. Gjithashtu, mbikëqyrja e ndërmjetësve të tregjeve financiare është një objektiv eficient për t’u ndjekur në përputhje me ligjin dhe aktet rregullative.

Bordi është pjesë aktive në ecurinë e projekteve që mbështesin rritjen institucionale të AMF-së, si: projekti i FSFC-së për regjistrin elektronik *online* të shitjeve të disa produkteve; projekti për forcimin e kapaciteteve, SECO, projekti për përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar...

Arben Ahmetaj – Zoti Melani, keni folur 13 minuta, kështu që ju kanë mbetur 2 minuta kohë.

Pajtim Melani – Në rregull!

Projekti kombëtar “Për sigurimin nga katastrofat”, ku secila nga këto projekte tashmë po koordinohet nga Ministria e Brendshme. Rritja e edukimit financiar; forcimi i kontrollit të brendshëm dhe komitetit të kontrollit ushtrohet nga tre anëtarë ekzekutivë të bordit.

Në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare vlen të përmendet vlerësimi i Komisionit European. Ne tashmë jemi në procesin *screening* për të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për të përputhur në mënyrë të plotë të gjithë legjislacionin tonë primar dhe sekondar me *acquis communautaire*

Faleminderit!

Arben Ahmetaj –A ka ndonjë pyetje për zotin Melani? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Melani.

Vazhdojmë me kandidatin tjetër, zotin Bilal Kola.

Bilal Kola – Faleminderit për ftesën!

I nderuar zoti kryetar, në radhë të parë, dëshiroj të siguroj të gjithë anëtarët e komisionit që jam nisur thjesht nga një njoftim i shpallur nga Kuvendi dhe më pas kam paraqitur kandidaturën time, duke plotësuar të gjitha kriteret formale që parashikohen në ligjin përkatës. Natyrisht, kam dëshirë që të pasqyroj këtu jetëshkrimin tim dhe t’u japë mundësinë të gjithë anëtarëve të komisionit të bëjnë pyetje për atë që unë do të prezantoj.

Arben Ahmetaj – Unë do t’ju lutesha që prezantimin tuaj ta bëni brenda 10 minutave, por nëse do të doni më shumë kohë...

Bilal Kola – Më mjaftojnë vetëm 5 minuta, pasi vetëm jetëshkrimin tim dua t’ju pasqyroj.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Bilal Kola – Faleminderit juve!

Nga pikëpamja e plotësimit të kriterëve besoj se kandidatura ime i plotëson kushtet qoftë nga pikëpamja e shkollimit, qoftë edhe të eksperiencës profesionale. Unë gjykoj se jam në ujërat tejet profesionale të çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtën tregtare apo aspektet mbikëqyrëse të ligjit dhe legjislacionit që fokusohet në këto aspekte.

Unë kam bërë doktoraturën në një universitet amerikan në Vjenë, i cili fokusuar në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën tregtare. Gjithashtu, aty kam pasur mundësinë që të jap leksione në të drejtën tregtare për rreth 3 vjet. Kam përfunduar masterin në London Guildhall University në Londër dhe i gjithë studimi ka qenë i fokusuar në të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare. Kam bërë studime bachelor në Universitetin South Bank të Londrës, ku të gjitha lëndët e zgjedhura i kam fokusuar tek e Drejta Tregtare.

Për sa i përket eksperiencës, kam 15 vjet që jam i fokusuar në menaxhim profesional, që ka të bëjë me fushën e të Drejtës Tregtare. Dua të veçoj katër vjet eksperiencë si drejtor juridik në Aeroportin e Tiranës, ku nga pikëpamja e mënyrës se si funksionon ajo korporatë, praktikisht çdo gjë është në nivel *outsourcing*, që do të thotë se departamenti ligjor që unë kryesoja praktikisht ishte bërës dhe mbikëqyrës i të gjitha kontratave që kjo korporatë i kalonte të tretëve për menaxhimin e të gjithë infrastrukturës apo shërbimeve që ofroheshin.

Përpara kësaj eksperience kam punuar në Ministrinë e Drejtësisë si kryetari i një grupi të posaçëm pune për përafrimin e ligjit shqiptar me atë të Bashkimit Europian, ku kemi përafruar një mori ligjesh të karakterit tregtar me standardet e BE-së.

Më pas kam menaxhuar firmën time konsulente, e cila ka qenë e fokusuar në të Drejtën Tregtare dhe aktualisht jam Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Integritetit të Përndjekurve Politikë. Pak a shumë kjo ishte një panoramë e asaj që doja të prezantoja.

Për sa i përket pozicionit përkatës, gjykoj që kandidatura ime i plotëson kriteret për një pozicion të tillë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje për zotin Kola? Nuk ka.

Faleminderit për prezantimin!

Vazhdojmë me zotin Olsi Çoku.

Ju lutem, zoti Çoku, maksimumi 10 minuta.

Olsi Çoku – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit për mundësinë që më dhatë të prezantoj veten përpara këtij komisioni. Është një kënaqësi dhe privilegj i veçantë!

Prezantimin do ta filloj duke treguar se kush jam dhe çfarë përfaqësoj në përmbushje të kriterëve ligjorë të ligjit të AMF-së dhe me pas me idetë e mia për drejtimin e bordit të këtij institucioni.

Eksperienca 10-vjeçare në fushën e konsulencës ligjore më ka bërë që të jem shumë pranë çështjeve tregtare, konsulencës së shoqërive tregtare, por edhe hartimit të legjislacionit. Këto kanë qenë dy fushat kryesore mbi të cilat kam vepruar.

Kam 7 vjet që punoj në sektorin privat, në një studio ligjore. Aty drejtoj Departamentin e Projekteve Financiare dhe të Konsulencës, ku japim konsulencë ligjore për shoqëritë tregtare, vendase dhe të huaja.

Për sa u përket punëve konkrete, 5 vjetët e fundit kam qenë i angazhuar në një konsulencë të financuar nga SEIKO, me një shumë prej 6.6 milionë eurosh për qeverinë shqiptare për rritjen e sektorit të gazit në Shqipëri, i cili në atë kohë ishte inekzistent. Kam bashkëpunuar me kompaninë gjermane “Ronald Berger” dhe gjatë këtyre viteve kemi arritur të themelojmë shoqërinë e parë të gazit, të cilën e kemi ndihmuar në licencimin dhe certifikimin e saj.

Gjithashtu kemi ndihmuar në hartimin e disa prej akteve nënligjore të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”. Së fundmi kemi krijuar GV-në e përbërë nga OST-ja shqiptare dhe OST-ja italiane e gazit SNAM, e cila do të mirëmbajë rrjetin e gazsjellësit TAP në Shqipëri në vitet e ardhshme.

Gjatë kësaj periudhe kemi asistuar edhe në bordin e ERE-s rreth 1 vit e gjysmë, ku kemi hartuar një sërë rregulloresh bashkë me ta, siç është metodologjia e tarifave dhe metodologjia e licencimit.

Për sa u përket reformave ligjore dhe sektoriale, kam ndihmuar në hartimin e ligjit “Për kujdesin shoqëror në Shqipëri” në vitin 2015, një projekt i financuar nga UNCEF-i, në të cilin kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Mirëqenies Sociale, në atë kohë.

Kemi hartuar një pjesë të bazës ligjore me akte nënligjore të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”.

Në një projekt tjetër, i financuar nga OSBE-ja, kemi hartuar VKM-në “Për funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës, për parandalimin e krimit mjedisor”.

Në një projekt të financuar nga BE-ja dhe nga Axfhencia Austriake për Zhvillim kemi riformtuar, së bashku me një grup konsulentësh ndërkombëtarë sektorin e konkursueshmërisë dhe inovacionit sipas kriterëve dhe propozimeve të BE-së.

Për sa i përket eksperiencës në sektorin konkret, ndër vite kam këshilluar disa kompani sigurimi të jetës dhe jo të jetës, duke ndjekur shpeshherë edhe procese gjyqësore. Në vitin 2013 kam qenë pjesë e grupit të punës, që arriti të finalizonte me sukses privatizimin e INSIG-ut, një nga licencat më të lodhshme, por më ka ndihmuar që të njoh çdo aspekt teknik të tregut financiar jobankar, më konkretisht atë të sigurimeve.

Në një prej bankave të nivelit të dytë, kam asistuar në fazën konceptuale të krijimit të Bursës Shqiptare të Titujve. Gjithashtu, kam ndihmuar edhe në derigjencën e krijimit të fondit të parë të pensioneve vullnetare.

Për sa u përket publikimeve profesionale dhe pjesëmarrjeve në grupe, kam asistuar që në fillesat e karrierës sime në forumet e juristëve të bashkive, ku kemi dhënë ndihmesa në akte nënligjore që dilnin nga bashkitë apo i propozoheshin parlamentit.

Jam kontribuues i një prej revistave ligjore më kryesore në botë që është “*Getting the dill through*” për sa i përket seksionit të *acquisition final*, pra projekte financiare të çdo lloi. Gjithashtu, jam edhe trajner i certifikuar nga USAID për parandalimin e konfliktit të interesave në pushtetin vendor.

Megjithatë, dua të them diçka edhe për konceptin dhe idenë time që kam për funksionimin e AMF-së si autoritet dhe më pas për tregjet financiare që ky autoritet menaxhon.

Ka nevojë për një rimendim rrënjësor të mënyrës se si AMF-ja bën transparente vendimmarrjet e saj dhe se si edukon qytetarët. Ka nevojë për një transparencë më të mirë në vendimmarrje dhe një përmirësim të bashkëpunimit institucional.

Dua të theksoj që është e papranueshme që ky Autoritet nuk ka adresuar çështjet e ngritura nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë në qershor të vitit 2018.

Kam një mendim për të integruar qasjet menaxheriale të detyrave funksionale të AMF-së, që janë: siguria e investitorëve dhe mbrojtja e konsumatorëve.

Mendoj që duhet bërë një edukim periodik i publikut për mjetet dhe instrumentet financiare, që janë nën mbikëqyrjen e AMF-së, pasi janë instrumente shumë të mira investimi dhe që mund të rrisin kapitalet e kompanive, por edhe të individëve.

AMF-ja si institucion ka nevojë që të marketojë më shumë punën e saj, sepse, për hir të vërtetës, publiku i gjerë nuk e njeh misionin e madh dhe të rëndësishëm që ka. Siç e thatë edhe ju në fjalën tuaj, është një mision që duhet të njihet, sepse nëpërmjet njohjes dhe edukimit publik edhe njerëzit kanë mundësi të krijojnë mënyra të reja investimi. Nuk mund të jemi të kufizuar vetëm në mundësitë që na jep sektori bankar sot.

Ka nevojë për një finalizim të përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*. AMF-ja e ka filluar, por ka ende nevojë për punë.

Ka nevojë edhe për një ristrukturim në disa prej drejtorive, ku është shumë e rëndësishme që ky institucion të përqaset më shumë me sektorin bankar dhe të ketë një drejtor të pastrimit të parave. Sot në këtë institucion ka vetëm një zyrtar që shërben si pikë kontakti me Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit të Parave dhe në këndvështrimin tim kjo nuk mjafton.

Në projektin e rritjes së kapaciteteve në industrinë e gazit natyror, nëpërmjet aftësive të mia, të përçoj të njëjtën praktikë ndërkombëtare edhe në bord, pra një mënyrë të re menaxhimi dhe disi më pranë standardeve ndërkombëtare. Këtu dua të citoj një vendim të komitetit

ekonomik të Dhomës së Lordëve në Britani, ku thuhet: “Ka më shumë nevojë për cilësi normash, sesa për sasi normash”. Pra, sot kemi sasi që shpeshherë nënkuptohet, një hartim më cilësor të këtyre normave do të ishte i mirëpritur. Unë si jurist jam i gatshëm të kontribuoj për këtë, edhe pse aplikoj për kryetar bordi, por e konceptoj veten në shërbim të këtij bordi, sepse, për hir të së vërtetës, nuk ka një jurist që të ketë praktikuar ligjin në këto vitet e fundit nga pesë anëtarët e bordit.

Për sa i përket tregut të sigurimeve, do të përqipemi të promovojmë gjenerimin e sektorëve të rinj. Ka shumë mundësi që të gjenerojmë biznes për kompanitë e sigurimit, për efekt të mbrojtjes së individëve që ushtrojnë profesione të ndryshme. Ligji ka adresuar disa sigurime të detyrueshme, por zgjerimi dhe shtimi i gamës së sigurimeve të detyrueshme besoj se do të mbronte më shumë konsumatorët, por do të ishte edhe një gjenerim biznesi dhe punësimi nga kompanitë e sigurimit. Duhet një rol më pro-aktiv në monitorimin e kompanive të sigurimit dhe subjekteve të licencuara në përgjithësi, duke siguruar zbatimin eficient të fondit të kompensimit, i cili, ashtu siç është adresuar edhe në rezolutën e Kuvendit, nuk është adresuar në mënyrën e duhur, por ka nevojë edhe për hartimin e akteve të nevojshme rregullatore për këtë fond.

Për sa i përket fondit të letrave me vlerë, edukimi i publikut me mundësinë që ofron tregu i letrave me vlerë është i domosdoshëm, sepse publiku nuk i njeh mundësitë që të japin instrumentet financiare. Sot është e vërtetë që Bursa Shqiptare e Titujve emeton vetëm tituj shtetërorë, por në të ardhmen me një soliditet më të mirë të tregut dhe me një monitorim rixhid të kompanive që do të emetojmë, do të kemi një mbrojtje më të mirë të investitorëve dhe një mundësi më të mirë për publikun, kompanitë dhe çdo pjesëmarrës në treg që dëshiron të investojë.

Dua të ndalem edhe në një aspekt teknik, miratimi i prospekteve të emetimit të obligacioneve kalon pa verifikim nga AMF-ja, e cila bën thjesht një verifikim normal. Nëse AMF-ja do të miratonte dhe do të bënte një analizë të mirëfilltë ligjore dhe ekonomike të prospekteve që miraton, besoj se do të rritej besimi dhe interesimi i investitorëve. Këtë ligji nuk e adreson, prandaj do të duhej edhe një ndryshim ligjor. Pra, duhet një zbatim i menjëhershëm dhe një adresim i rezolutës së Kuvendit.

Për sa u përket fondeve të pensioneve vullnetare, duhet të hartohet i një strategji që të lehtësojë skemën e pensioneve publike, duke bërë një integrim të të dyja skemave nga skema e solidaritetit të pensioneve publike. Pra, duke menduar për një zgjidhje ligjore, të cilën unë e kam në kokë, për të ndihmuar në kontributin e individëve në fondin e pensioneve vullnetare dhe të jetë një fond që t’i kthehet të njëjtit individ. Pra, duhet promovimi i këtyre instrumenteve

kundrejt primeve, me një kosto pak më të ulët, gjithashtu duhet edhe një komunikim më efektiv e adresim i mungesës së njohurive e të vetëdijes së publikut, për rëndësinë e madhe që kanë fondet e pensioneve vullnetare. E dimë që skema e pensioneve publike ndoshta nuk mund të jetë më *sustainable*, siç është në ditët e sotme, prandaj njerëzit duhet të investojnë për kalimin e pensionit sa më të qetë.

Ndërkohë që sot në AMF mungon edhe një ngritje e sistemit të raportimit *online*, siç është për policat e sigurimit të jo jetës, një sistem i tillë për policat e sigurimit të jetës. Kaq kisha, jam i hapur për pyetjet.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Çoku!

A ka ndonjë pyetje?

Ervin Bushati – Është shumë interesante ideja jote për funksionimin e bursës edhe, pse nuk është bërë deri më sot. Këtë e shikoj edhe në studimin e FMN-së dhe Bankës Botërore, ndërkohë që niveli i interesave në treg është në normën më të ulët dhe NPL-të kanë rënë. Pra, si mendoni se mund të influencohen firmat shqiptare që kanë likuiditet në banka për t'u afruar më shumë në tregun e aksioneve dhe si mund të formatizohet kjo? Pra, si mund të funksionojë një bursë ashtu siç thatë ju, kur deri tani ajo është e kornizuar, sepse është vetëm shteti, ndërkohë që ka firma që kanë likuiditet dhe ky është momenti për t'u futur dhe çfarë mund të bëjmë ne si ligjvënës?

Arben Ahmetaj – Një përgjigje maksimumi 2 minuta. Faleminderit!

Olsi Çoku – Kuadri ligjor sot e lejon, por duhet të rritet besueshmëria e publikut dhe e investitorëve. Kjo rritet nëpërmjet edukimit të transparencës së vendimmarrjes së AMF-së, ajo që thashë që në fillim të fjalës sime. Pra, publiku është i paedukuar, prandaj duhet një edukim periodik për mundësitë që japin tregjet financiare të letrave me vlerë. Për të arritur tek investimi me instrumentet financiare private, duhet një rritje e besimit për sa i përket qëndrueshmërisë financiare të subjekteve që do të emetojnë këta tituj dhe të atyre që do t'i blejnë. Kjo kërkon një rigorozitet në monitorim dhe në raportimet periodike që bëjnë subjektet e mbikëqyrura në AMF. Pra, vetëm kur kompanitë e besueshme auditimi, ndoshta të pavarura, ndoshta edhe nga palë të treta, ndërkohë mendoj edhe për zgjidhje ligjore, do të konfirmonin soliditetin financiar të këtyre shoqërive, atëherë tregu do të jetë gati që të investojë në tituj privatë, pra jo të shtetit shqiptar. Hapësira ligjore ekziston, jam në dijeni të ligjit për titujt që po bëhen, ndoshta disa rregullime të vogla do të mundësojnë një investim të tillë në një kohë jo të largët.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Çoku!

Vazhdojmë me zotin Çollaku. Zoti Çollaku, keni 10 minuta për prezantimin, pastaj do të prisni pyetjet nga kolegët.

Ardit Çollaku – I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave,

Më vjen keq që nuk është opozita prezent. Unë si pararendësit e mi, aplikimin tim e kam bërë pasi pashë thirrjen që ishte shpallur në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë dhe në përmbushje të kriterëve që kërkoheshin plotësova dokumentacionin përkatës dhe e dorëzova pranë protokollit. Si kandidaturë, mendoj se i plotësoj të gjitha kriteret që kërkoheshin në këtë thirrje.

Kurikula ime fillon që nga vitit 2009 mbas përfundimit të studimeve që kam kryer në Universitetin e Sapienza-s në Romë, në fushën e drejtësisë. Më pas kam vijuar bashkëpunimet me zyra shumë të rëndësishme në Itali, njëra prej të cilave ka qenë edhe ajo e ish-ministrit të financave Augusto Fantoci, me të cilin kam bashkëpunuar për tre vjet në fushën e të Drejtës Tregtare dhe Tregtare Ndërkombëtare, ku kemi pasur një numër shumë të madh të kompanive apo shoqërive ndërkombëtare me famë botërore, të cilat i kemi ndjekur juridikisht.

Gjatë vitit 2010 kam aplikuar për një tjetër master profesional gjithmonë për të Drejtën Fiskale dhe Tregtare, me të cilin jam zhvilluar nga ana profesionale për këtë fushë. Kam vijuar bashkëpunimin me zyrat e tjera ligjore jo vetëm italiane, por edhe shqiptare. Kjo ka bërë që në vitin 2010 të licencohem pranë Dhomës së Avokatisë në Tiranë, për titullin e “Avokatit”, të cilin e kam edhe në Itali. Kam vijuar më tej me bashkëpunime të ndryshme profesionale, ku kam hapur edhe një zyre përfaqësie italiane në Tiranë, me të cilën kemi ndjekur dhe kemi vijuar bashkëpunimin edhe me fondacione apo organizata joqeveritare me famë të madhe, në fusha të ndryshme, pra jo vetëm të së drejtës tregtare, por edhe ato të siguracioneve apo të ndihmës ekonomike ligjore që mund t’u jepeshin këtyre fondacioneve.

Në vitin 2013 kam pasur fatin e mirë të bëhem pjesë e kabinetit të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe të vijoj procedurat për sa i përket këshillimit ligjor, plotësimit apo detyrimit përkatës për pjesëmarrjen në grupet e punës, në përgatitjen ligjore të hartimit të direktivave apo urdhrave të zbatueshëm pranë administratës publike shqiptare, si dhe ndjekjen e direktivave apo zbatimin e normativave dhe rregulloreve që vinin nga synimi i aspiratës pranë Bashkimit European. Ne, si pjesë e administratës, kemi qenë në ndjekje të vazhdueshme dhe vijojmë procedurat për zbatimin e tyre.

Gjatë vitit 2016 kam drejtuar Axhencinë Kombëtare të Turizmit, një nga institucionet kryesore për promovimin e turizmit në vend, në të cilin kam pasur fatin të njihem me shumë institucione të tjera paralele, të cilat vijnë të bashkëpunojnë jo vetëm me këtë institucion, por edhe me operatorët përkatës të kësaj fushe, duke e ngritur lart jo vetëm aspektin e sektorit turistik në Shqipëri, por edhe duke përmirësuar legjislacionin përkatës për sa i përket fushës dhe sektorit të turizmit në përgjithësi në vendin tonë. Kemi pasur një qasje tërësisht europiane, kjo shikohet edhe falë statistikave dhe shifrave që e kanë kthyer turizmin në një nga sektorët prioritarë të vendit.

Gjatë vitit 2018, pasi jam liruar nga kjo detyrë, kam vijuar punën time private në ndjekjen dhe këshillimin ligjor të shumë shoqërive kombëtare dhe ndërkombëtare dhe vijoj ta kryej këtë funksion. Gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar kam përfunduar edhe studimet për dokturaturë në Universitetin Sapienza të Romës, për një temë që lidhet me të Drejtën Energjetike Europiane, ku përafrohet rregullatori dhe direktivat e të Drejtës Europiane me legjislacionin shqiptar dhe italian.

Në mbyllje të prezantimit unë ju ftoj të merrni parasysh kandidaturën time, pasi nuk është vetëm një aspiratë që kam për këtë pozicion, si kryetar i bordit, në ndryshim me sa u tha paraprakisht, sepse dikush iu referua edhe detyrave që ka drejtori i përgjithshëm i këtij institucioni, unë do të theksoja që kryetari i bordit në vijim të zhvillimit të procedurave dhe ndjekjes së zbatimit që ka ligjvënësi shqiptar, do të ndjekë gjithashtu edhe aspiratat me të cilat ne drejtohem për të marrë modelet dhe politikat më të mira të vendeve të zhvillimit europian.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Çollaku!

A ka ndonjë pyetje për zotin Çollaku? Nuk ka.

Faleminderit!

Do t'i kërkoja medias të na linte për një konsultë të komisionit dhe pastaj do t'ju ftoj më sërisht.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti

